



## Përmbajtja e programit

**Q**endra e Studimeve Parlamentare në bashkëpunim me Programin e Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (Soros) kanë iniciuar Programin “Rritja e Pjesëmarrjes së Publikut në Procesin Legjislativ” Qëllimi i programit është të forcojë pjesëmarrjen e publikut në proceset legjislative dhe vendimmarrëse të qeverisjes, duke synuar zhvillimin e praktikave demokratike dhe forcimin e shtetit ligjor në Shqipëri.

Objektivat e programit janë rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në proceset e qeverisjes si dhe fuqizimi i shoqërisë civile për të kërkuar dhe monitoruar proceset qeverisëse për një qeverisje më transparente dhe të përgjegjshme.

### Metodologjia

Programi ka në fokusin qëndror proceset legjislative, por në një vështrim më të gjerë, adresimin e pjesëmarrjes së publikut në të

gjitha sferat e qeverisjes. Hartimi i këtij programi ka ardhur si përgjigje ndaj kërkesave të partnerëve të shoqërisë civile për të siguruar informacion dhe mbështetje në kapacitetet mbrojtëse në zbatimin e politikës dhe legjislacionit, çështje që lidhen me shpërndarjen e shërbimeve dhe pjesëmarrjes demokratike në përgjithësi.

Programi, parashikon ngritjen dhe strukturimin e tre njësive bërthamë:

- **Njësia e Monitorimit**
- **Njësia e Trajnimit dhe Advokacisë**
- **Njësia e Informimit**

Ky projekt përfshin disa aktivitete që do të ndihmojnë për të krijuar një informacion, analizë dhe bazë të nevojshme për të vlerësuar situatën dhe rezultatet që do të arrihen. Kjo do të ndihmojë më pas për ta shtrirë programin në veprimtaritë e tjera që parashikohen në këtë vizion.

### Përsa i përket njësisë së monitorimit

Do të monitorohen politikat dhe proceset e hartimit dhe shqyrtimit të legjislacionit të Ekzekutivit dhe Parlamentit dhe do të nxitet dhe mbështetet lobimi për promovimin e pjesëmarrjes së publikut në këto procese.

Njësia do të shpërndajë informacion në një rrjet të OJF-ve, do t'i pajisë ato me informacionin e nevojshëm për aktivitetet e tyre të advokacisë.

QSP do të mbajë sesione informuese, që fokusohen në zhvillimet kyçe politike dhe legjislative që synojnë identifikimin e politikës dhe zbatimin në lidhje me proceset që përfshihen në hartimin e asaj politike apo legjislacioni të veçantë.

Çdo organizatë apo individ që dëshiron të përfshihet në këtë program duhet të plotësojë formën e *(Vijon në faqen 2)*

## NË KËTË NUMËR DO TË LEXONI

**PËRMBLEDHJE MBI  
VEPRIMTARINË E  
QSP NË KUADËR TË  
PROGRAMIT**

Faqe 3

**NGA PUNIMET E  
KUVENDIT  
PËR PERIU DHËN  
1-15 MARS 2004**

Faqe 4

**KALENDARI 2  
JAVOR (15-25 MARS  
2004) I PUNIMEVE  
TË KUVENDIT**

Faqe 5

# RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

(Vijon nga faqja 1)  
rrjetit të advokacisë Online.

## Përsa i përket njesisë së Informimit

Kjo njësi do të monitorojë zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit mbi dokumentat zyrtare, do të llobojë dhe asistojë inisiativat e qeverisë për hartimin dhe zbatimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit.

Një drejtim tjetër do të jetë asistencë ligjore për individët dhe organizatat që janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim. Për këtë qëllim pranë njesisë do të kontraktohet një avokat për ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore.

Do të hartohen dhe shpërndahen broshura informuese mbi të drejtën e informimit për publikun dhe administratën.

Përmes këtij programi, QSP do të sigurojë analizën e politikave dhe të çështjeve të tjera ligjore që kanë impakt në sferat e qeverisjes qendrore dhe vendore; dhe do të shpërndajë këtë analizë përmes seminareve të rregullta dhe raportve të shkruara.

## Përfituesit

Përfituesit e programit janë grupet e interesuara të shoqërisë civile dhe strukturat qeverisëse që do të përfitojnë nga procesi i konsultimit dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen legjislative.

Afati i zhvillimit të Programit Programi është parashikuar të zhvillohet në një periudhë një vjeçare duke filluar nga 1 gusht 2003.

# Transparenca dhe publiciteti parlamentar

**E** drejta e informimit dhe transparenca marrin kuptime dhe vlera të ndryshme në kontekste të ndryshme. Për organet ligjvënëse ato marrin një rëndësi të veçantë. Transparenca siguron që përfaqësuesit e zgjedhur të jenë në kontakt me publikun dhe të përgjigjen përpara tij. Që zgjedhësit të bëjnë vlerësime dhe të zgjedhin nga veprimet politike të ndërmarra nga përfaqësuesit e tyre, organet e zgjedhura duhet t'i zhvillojnë punimet e tyre të hapura dhe të informojnë zgjedhësit gjatë procesit vendimarrës. Në qoftë se publiku nuk mund të vëzhgojë se si përfaqësuesit e tyre e përdorin mandatin për të cilin ata janë zgjedhur, atëherë ushtrimi i zgjedhjes elektorale bëhet pa kuptim.

## 1. Garancitë Kushtetuese

Në Kushtetutë, në kreun për liritë dhe të drejtat vetjake, në nenin 23 deklarohet se **“E drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrjnë funksione shtetërore. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.”**

Këto të drejta dhe liri mund të kufizohen me ligj në rastet që përbëjnë “masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurimit kombëtar, të integritetit territorial, për mbrojtjen e sigurisë dhe të rendit publik, për parandalimin e krimeve, për mbrojtjen e shëndetit dhe të moralit, të reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve, për parandalimin e dhënies së informacionit të marrë në konfidencë, si dhe për të garantuar autoritetin dhe paanësinë e pushtetit gjyqësor”. Respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, të njohura në Kushtetutë, në instancë të fundit duhet të garantohet nga Gjykata Kushtetuese.

Në disa kushtetuta të vendeve të europës perëndimore i është dhënë një rëndësi më e veçantë të drejtës për informim dhe transparencës. Kështu në kushtetutën Suedeze përcaktohet në mënyrë të qartë detyrimi i organeve shtetërore për t'i krijuar mundësi publikut për t'u njohur me dokumentat zyrtare, procedurën për realizimin e kësaj të drejte si dhe rastet e veçanta kur ajo mund të kufizohet. Një detyrim i tillë për organet shtetërore parashikohet edhe në kushtetutën Hollandeze. Parimi i zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Kuvendit është i njohur nga Kushtetuta, në nenin 79. Në raste të veçanta Kuvendi mund të

vendosë që një mbledhje të zhvillohet me dyer të mbyllura kur kërkohet nga Presidenti i Republikës, Kryeministri ose një e pesta e deputetëve dhe për këtë vendosin shumica e të gjithë deputetëve. Rregullim më të hollësishëm ky parim gjen në rregulloren e Kuvendit, e cila do të trajtohet më poshtë.

Detyrimi për botimin e ligjeve në Fletoren Zyrtare përcaktohet në nenin 84 të Kushtetutes. Për aktet e ekzekutiv (të Këshillit të Ministrave dhe të Ministrave), detyrimi për botim në Fletoren Zyrtare është vetëm për ato me karakter normativ.

Një element të ri që ka sjellë Kushtetuta në këtë drejtim është dhe detyrimi për botimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që ratifikohen me ligj.

## 2. Zhvillimi i seancave plenare të hapura

Seancat plenare të Kuvendit zhvillohen të hapura, me përjashtim të rasteve kur Kuvendi vendos ndryshe sipas parashikimit në Kushtetutë. Rregullorja e Kuvendit përcakton se për shqyrtimin e buxhetit ose për projektligje financiare nuk mund të kërkohet zhvillimi i seancës me dyer të mbyllura. Kur vendoset që seanca të zhvillohet me dyer të mbyllura, procesverbalet, diskutimet dhe regjistrimet radiotelevizive të këtyre mbledhjeve administrohen sipas rregullave të sekretit shtetëror. Vendimet që merren shpallen publikisht. Në praktikën parlamentare, nga viti 1991 dhe në vazhdim, kemi vetëm dy raste të zhvillimit të seancave me dyer të mbyllura, gjatë legjislaturës së 15-të.

Persona nga publiku mund të marrin pjesë në seancat e Kuvendit. Këta persona më parë pajisen me një fletë-hyrje dhe duhet të qëndrojnë në galeri, vend i përcaktuar për publikun. Kapaciteti i galerisë është për 240 persona. 66 vende janë të rezervuara në llozha për personalitetet e larta shtetërore dhe për trupin diplomatik. Në praktikë persona të ndryshëm nga publiku i marrin ftesat nëpërmjet deputetëve ose grupeve parlamentare.

Për përfaqësuesit e medias, shtetërore apo të pavarur, nuk ka ndonjë pengesë për të ndjekur mbledhjet e Kuvendit. Krijohet një listë me emrat e gazetarëve që kanë të drejtë të hyjnë në galeri në mesin e Kuvendit mbi bazën e kërkesave të bëra në mënyrë paraprake. Në galeri nuk ka vende të veçanta për përfaqësuesit e medias të ndara nga ato të publikut, ndërsa për gazetarët e RTSH dhe për aparaturat teknike janë caktuar dy llozha.

# PËRMBLEDHJE MBI VEPRIMTARINË E QSP NË KUADËR TË PROGRAMIT

## Njësia e Monitorimit

1. Gjatë muajit dhjetor 2003 u bë monitorimi i procesit të shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit në Kuvend. Monitorimi, duke patur parasysh pozicionin qëndror që ka Komisioni i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit në shqyrtimin e buxhetit, u përqëndrua në këtë komision. Ky komision në këtë periudhë zhvilloi dymbëdhjetë mbledhje, të cilat ishin të hapura për median dhe për publikun. Në katër mbledhje, përveç përfaqësuesve të qeverisë dhe institucioneve shtetërore u ftuan përfaqësues të organizatave jofitimprurëse dhe të biznesit për të paraqitur opinionet e tyre. Çështjet që tërhoqën më shumë interes për këto subjekte ishin buxheti për arsimin dhe taksat dhe tarifata doganore për bujqësinë. Nga monitorimi vlerësohet se ka nevojë për një proces konsultimi më të gjerë nëpërmjet seancave të dëgjimit.

## Njësia e Trajnimit dhe Advokacisë

2. **Tryezë e rumbullakët për prezantimin e programit :** Në 17 dhjetor 2003, në Hotel Rogner u zhvillua tryeza e rumbullakët: « Pjesëmarrja e publikut në procesin legjislativ ». Në këtë tryezë u prezantua programi dhe u diskutua nga pjesëmarrësit për bashkëpunimin në kuadrin e këtij programi për rritjen e pjesëmarrjes dhe konsultimit të shoqërisë civile gjatë hartimit të projektligjeve në ekzekutiv, gjatë shqyrtimit të projektligjeve në Kuvend si dhe gjatë procesit të hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit.

3. **Rrjeti i organizatave të interesuara dhe grupeve të presionit në hartimin e politikave dhe buletini elektronik; pjesëmarrja e biznesit:** Është ndërtuar një rrjet organizatash dhe subjektsh të interesuara, me adresat e tyre elektronike, për procesin legjislativ, rrjeti i cili do të përdoret dhe për lobimin dhe zhvillimin e strategjive efektive në procesin e advokacisë. Këtij rrjeti do ti shpërndahet Buletini 2-javor, i cili do të përmbajë informacione të ndryshme mbi zhvillimet aktuale në procesin legjislativ; si zhvillimet e fundit në Kuvend, projektligje të miratuara dhe në diskutim, zhvillimet e ndryshme në Qeveri (nga mbledhjet në Këshillin e Ministrave) dhe projektligjet e miratuara, informacione të ndryshme etj. Ky Buletin mund të gjendet dhe në faqen e internetit, ku ne do të mirëpresim grupet e interesuara të regjistruhen online, për të marrë rregullisht Buletinin 2-javor.

## Njësia e Informimit

4. **Asistenca ligjore për individët dhe organizatat që janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim:** Duke filluar nga 15 nëntori 2003 në zyrat e QSP kanë filluar shërbimi ligjor falas për të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim. Këto subjekte kanë mundësinë që në këtë fushë ligjore të marrin asistencë ligjore nga një avokat i cili është në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 - 17.00. Gjatë kësaj periudhe kanë kërkuar konsultim dhe informacion kryesisht individë të cilët janë

asistuar më pas në depozitimin e kërkesës së tyre në insitucionet përkatëse. Nga praktikat e kryera nuk kemi çështje për të cilat dilte nevoja e ankimit administrativ ose gjyqësor. E drejta e informimit konstatohet se, pavarësisht nga kërkesat, njihet dhe përdoret pak nga individët dhe organizatat. Për këtë qëllim ka nevojë për më shumë sensibilizim dhe informim për mundësitë ligjore që i jep kjo e drejtë.

5. **Faqja e internetit:** Në faqen tonë të internetit, [www.ascdpd.org](http://www.ascdpd.org) do të gjeni direktorinë – Pjesëmarrja në Procesin Legjislativ, e cila përmban dy nëndirektori (në Kuvend, në Ekzekutiv) ku përkatësisht gjenden; Programi i punimeve, Kalendari i punimeve, Raporte të komisioneve parlamentare, Si mund të informohemi për procesin legjislativ në Kuvend, Si mund të merni pjesë në procesin legjislativ në Kuvend, dhe për Ekzekutivin; Programi Legjislativ i Ministrive, Programi Legjislativ i Këshillit të Ministrave, Projektakte normative në proces, Si mund të informohemi për procesin e vendimarrjes në qeveri, Si mund të merrni pjesë në vendimarrje. Gjithashtu nëpërmjet faqes tonë ju mund të regjistruheni për të marrë kopje të Buletinit 2-javor.

6. **Botimet në proces:** QSP, në kuadër të këtij projekti, është duke përgatitur një sërë bukletesh informative. Së shpejti do të përfundojnë bukletet mbi procesin legjislativ dhe ai mbi të drejtën e informimit dhe transparencën në procesin vendimarrës.

# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-15 MARS 2004

## 1. Projektligji “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”

Projektligji synon intensifikimin e forcës goditëse të shtetit në luftë kundër krimit të organizuar, trafikëve, korrupsionit dhe terrorizmit, nëpërmjet krijimit me ligj të strukturave të specializuara të drejtësisë, të pajisura me mjetet teknike dhe procedurale përkatëse. Në të parashikohet marja e një sërë masash për sigurimin e mbrojtjes së dëshmitarëve, të cilat grupohen në masa procedurale dhe masa joprocedurale.

Gjatë diskutimit të projektligjit në komisionet e përherëshme të Kuvendit dhe në seancë plenare deputetët e mbështeten atë në parim, duke miratuar ndryshime në formulimin e disa neneve, me qëllim saktësimin e përmbajtjes së tij. Përfaqësuesit e Qeverisë kërkuan mbështetjen e Kuvendit për krijimin e strukturave të parashikuara në projektligj për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë. Gjithashtu, deputetët theksuan domosdoshmërinë e shoqërimin të këtij projektligji me ndryshimet përkatëse procedurale në Kodin e Procedurës Penale, konkretisht të dispozitave që kanë të bëjnë me paraqitjen dhe pyetjen e dëshmitarëve.

## 2. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Projektligji është nismë e një grupi deputetësh dhe ka për qëllim lejimin e shërbimit në detyrë deri në moshën 68 vjeç të punonjësve të brendshëm akademikë me titull “profesor”, me qëllim që të thithet kontributi i tyre edhe pas moshës 65 vjeç. Miratimi i tij nuk ka efekte financiare në shtimin e shpenzimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare disa deputetë, veçanërisht anëtarët e Komisionit të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit, e quajtën të panevojshëm hartimin e këtij projektligji. Sipas tyre, ligji “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” nuk e detyron punëdhënësin të largojë nga puna punëmarrësit, që kanë plotësuar kushtet për pension pleqërie dhe njëkohësisht, nuk i ndalon të mbajë në punë punëmarrësit, me pëlqimin e tyre, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie. Ata ishin të mendimit që, meqenëse nuk ka pengesa ligjore që profesorët të vazhdojnë të punojnë tej moshës së daljes në pension, nuk është i nevojshëm një ndryshim i tillë i projektligjit.

Një pjesë tjetër e deputetëve, anëtarë të Komisionit të Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore dhe të komisioneve të tjera të përherëshme të Kuvendit, mbështetën nevojën e hartimit të një ndryshimi të tillë ligjor, i cili, sipas tyre, është në përputhje me legjislacionin e shumë vendeve të tjera. Por duke mbështetur mendimin e përfaqësuesve të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, ata theksuan se ky ndryshim ligjor nuk duhet bërë në ligjin “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” për të mos prishur skemën bazë të daljes në pension sipas këtij ligji dhe propozuan ndryshimin e ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Në përfundim, Kuvendi miratoi me shumicë votash që lejimi i shërbimit në detyrë të profesorëve deri në moshën 68 vjeç të bëhet në ligjin “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

## 3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Kuvendi diskutoi dy nisma të ndryshme ligjvënëse të Këshillit të Ministrave në ligjin “Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”.

Projektligji i parë synon mbulimin nga Instituti i Kujdesit Shëndetësor

të disa ekzaminimeve që kryhen nga Qendra Spitalore Universitare, nëpërmjet përdorimit të aparaturave të ndryshme, të cilat janë të kushtueshme.

Gjatë diskutimit të këtij projektligji deputetët, veçanërisht anëtarët e Komisionit të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit, u ndalën në mundësinë e përbalimit të kostonë së këtyre ekzaminimeve nga Instituti i Kujdesit Shëndetësor. Pasi dëgjuan informacionin e përfaqësuesve të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrisë së Financave, deputetët u shprehën dakort me projektligjin, duke vendosur që kostoja e ekzaminimeve që do të kryejë Qendra Spitalore Universitare për vitin 2004 të përballohet nga Këshilli i Ministrave, ndërsa për vitin 2005 e në vijim do të duhet të rriten transfertat e fondeve buxhetore për këtë Institut.

Projektligji tjetër ka të bëjë me kalimin e reformës së mbledhjes së kontributeve të sigurimeve shëndetësore në Drejtorinë e Përgjithshme të tatimeve, ashtu siç vepohet dhe për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore. Deputetët u shprehën dakort me një ndryshim të tillë.

Mbështetur në teknikën legjislative, deputetët u shprehën për bashkimin e të dy projektligjeve në një projektligj të vetëm, meqenëse të dyja ndryshimet ligjore propozohen të bëhen në të njëjtën ligj. Kuvendi miratoi disa ndryshime të terminologjisë së përdorur në formulimin e disa dispozitave, duke e përputhur atë me terminologjinë e përdorur në ligje të tjera.

## 4. Raporti i Avokatit të popullit për veprimtarinë e këtij Institucioni gjatë vitit 2003

Avokati i Popullit, Emir Dobjani, bëri një përkthim të detajuar të punës së organeve dhe autoriteteve publike në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut, si dhe prezantoi zgjidhjet e rasteve të ankimuar në këtë Institucion, të cilat, sipas tij, duhet të shërbejnë si udhërrëfyes për veprimet e organeve përgjegjëse të administratës në situata të ngjashme.

Në raportin e zotit Dobjani një vend të veçantë kanë zënë marrëdhëniet e Institucionit që ai drejton me mediat, si një mjet efikas për të siguruar informacionin e nevojshëm në publik dhe për të krijuar individualitetin e Institucionit. Po kështu, marrëdhëniet me Kuvendin, Gjykatën Kushtetuese bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut etj, ishin pjesë e fjalës së tij. Në përfundim, zoti Dobjani pasqyroi hollësisht rekomandimet që Institucioni i Avokatit të Popullit u ka dhënë dikastereve të ndryshme në bazë të këtyre vërejtjeve ose ankesave të qytetarëve.

Pas diskutimeve, Kuvendi e miratoi raportin e paraqitur nga Avokati i Popullit.

## 5. Raporti i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për veprimtarinë e tij gjatë vitit 2003

Raporti pasqyron arritjet dhe problemet e hasura gjatë vitit 2003 në veprimtarinë e medias elektronike dhe marrëdhëniet e krijuara me KKRT-në, si institucioni monitorues dhe rregullator i kësaj veprimtarie.

Gjatë diskutimit të këtij raporti problemi më i diskutueshëm ishte mënyra se si zbatohet nga operatorët radiotelevizivë detyrimi ligjor mbi bilancet vjetore, problem që konsiderohet shqetësues, veçanërisht për sigurimin e burimeve financiare të tyre dhe si ushtrohet kontrolli i veprimtarisë së tyre nga organet e përcaktuara me ligj. Probleme të diskutueshme ishin edhe mbulimi me sinjal radioteleviziv, kryesisht të zonave të thella, tregu i reklamave shtetërore, transmetimet dixhitale etj.

Në përfundim, Kuvendi miratoi raportin e paraqitur nga kryetari i KKRT-së.

# KALENDAR I

## 2 JAVOR (15-25 MARS 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

**E Hënë, datë 15.03.2004,  
ora 17.00**

**- Seancë Plenare -**

1. Miratimi i Kalendarit 2 javor të Punimeve të Kuvendit.

**P/ligje për Votim:**

1. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për projektin e Mbrojtjes së Mjedisit të Liqenit të OHRIT/masa shoqëruese".
2. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë, për transportin detar, tregtar".
3. P/Ligji "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpuntorëve të drejtësisë".
4. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (paraqitur nga një grup deputetësh).
5. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë".
2. P/Rezolutë "Për Çështjen e popullsisë çame".
3. Raport i Këshillit Kombëtar të Radio Televizionit (KKRT-së).
  - Pyetje.
  - Diskutime.

4. P/Vendim "Për miratimin e Raportit të Këshillit Kombëtar të Radio-Televizionit.

**E Martë, datë 16.03.2004**

**E Mërkurë, datë 17.03.2004**

- Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare "Për shpëtimin e jetës në det (SOLAS), 1974 të ndryshuar dhe Protokollin e kësaj konvente të vitit 1978, të ndryshuar".
  - **Komisioni i Ligjeve**
  - **Komisioni i Industrisë**
  - **Komisioni i Jashtëm**
2. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së ekstradimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Arabe të Egjiptit".
  - **Komisioni i Ligjeve**
  - **Komisioni i Jashtëm**
3. P/Ligji "Për medaljet për personelin e forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë".
  - **Komisioni i Ligjeve**
  - **Komisioni i Mbrojtjes (e ka shqyrtuar)**
4. P/Ligji "Për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës".
  - **Komisioni i Ligjeve**
  - **Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit (e ka shqyrtuar)**
  - **Komisioni i Ekonomisë dhe Financës (e ka shqyrtuar)**
5. P/Ligji "Për industrinë ushqimore".

more".

- **Komisioni i Ligjeve**

- **Komisioni i Industrisë**

- **Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit**

- **Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**

6. P/Ligji "Për shërbimin publik funeral".

- **Komisioni i Ligjeve**

- **Komisioni i Industrisë**

7. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për punimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre".

- **Komisioni i Ligjeve**

- **Komisioni i Industrisë**

- **Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**

8. P/Ligji "Për kriteret dhe kushtet që do të ndiqen për organizimin e ndarjes Administrativo-Territoriale të Republikës së Shqipërisë".

- **Komisioni i Ligjeve**

- **Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**

9. P/Ligji "Për disa shtesa në ligjin nr. 7973, datë 26.7.1995 "Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", të ndryshuar.

- **Komisioni i Ligjeve**

- **Komisioni i Ekonomisë dhe Financës**

10. Shqyrtimi i propozimit të Këshillit të Ministrave "Për lirim dhe emrim të Kryetarit (Vijon në faqen 6)

(Vijon nga faqja 5)

dhe Anëtarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve”, si dhe për emërimin e një anëtari të Entit Rregullator të Telekomunikacionit.

- **Komisioni i Industrisë**  
- **Komisioni i Ligjeve**

11. Dekret nr. 4156, datë 2.03.2004 “Për emërimin e Anëtarit të Gjykatës së Lartë” (zonja Shpresa Beçaj).

**Komisioni i Ligjeve**

**E Enjte, datë 18.03.2004, ora 10.00**

- **Seancë Plenare**

1. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8562, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.
2. P/Ligji “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”.
3. P/Ligji “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
4. Shqyrtimi i propozimit të Këshillit të Ministrave “Për lirim dhe emërim të Kryetarit dhe Anëtarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve”, si dhe për emërimin e një anëtari të Entit Rregullator të Telekomunikacionit.
5. Dekret nr. 4156, datë 2.03.2004 “Për emërimin e Anëtarit të Gjykatës së Lartë” të zonjës Shpresa Beçaj.
6. Interpelancë me debat me Ministrin e Industrisë dhe Energjetikës, kërkuar nga depute-

ti Sokol Olldashi.

\* \* \*

**E Hënë, datë 22.03.2004**

- **Pushim** -

**E Martë, datë 23.03.2004,**

**ora 17.00**

- **Seancë Plenare**

1. Raport i Kontrollit të Lartë të Shtetit.
- Pyetje.
- Diskutime.

**E Martë, datë 23.03.2004, ora 10.00**

**E Mërkurë, datë 24.03.2004, ora 10.00**

- Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. P/Ligji “Për medaljet për personelin e forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

- **Komisioni i Ligjeve**

- **Komisioni i Mbrojtjes**

2. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7875, datë 23.11.1994 “Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë”, i ndryshuar.

- **Komisioni i Ligjeve**

- **Komisioni i Bujqësisë dhe**

**Ushqimit (e ka shqyrtuar)**

3. P/Ligji “Për produktet e ndërtimit”.

- **Komisioni i Ligjeve**

- **Komisioni i Industrisë**

4. P/Ligji “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.

- **Komisioni i Ligjeve**

- **Komisioni i Punës dhe**

**Çështjeve Sociale**

- **Komisioni i Ekonomisë dhe**

**Financës**

- **Komisioni i Industrisë**

5. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8366, datë 2.7.1998 “Për shërbimin gjeologjik shqiptar (SH.GJ.SH)”.

- **Komisioni i Ligjeve**

- **Komisioni i Industrisë**

- **Komisioni i Ekonomisë**

**dhe Financës**

6. P/Ligji “Për miratimin e Kodit Detar Shqiptar”.

- **Komisioni i Ligjeve**

- **Komisioni i Mbrojtjes**

- **Komisioni i Industrisë dhe**

**Telekomunikacionit**

7. P/Ligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

- **Komisioni i Ligjeve**

- **Komisioni i Ekonomisë dhe**

**Financës**

**E Enjte, datë 25.03.2004, ora 10.00**

- **Seancë Plenare**

1. P/Ligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen Europiane për shënimin e rrugëve, Gjenevë 1957”.
2. P/Ligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare “Për kufizimin e përgjegjësive për reklamimet detare, 1976, dhe në Protokollin e vitit 1996”.
3. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7829, datë 1.06.1994 “Për noterinë”.
4. P/Ligji “Për dia shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8576, datë 3.02.2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”.
5. P/Ligji “Për një ndryshim një ligjin nr. 8677, datë 2.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

**Denada BRESHANAJ**

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator

Qendra e Studimeve Parlamentare/Centre for Parliamentary Studies

Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15

Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214; [cps@albaniaonline.net](mailto:cps@albaniaonline.net);

[www.ascdp.org](http://www.ascdp.org)